

VENDIM
Nr.23, datë 22.2.2008

**PËR KËRKESËN E SHOQËRISË “ALBANIA GREEN ENERGY” SHPK PËR
KUALIFIKIMIN E IMPIANTIT PRODHUES (BLOK MOTORË-GJENERATORË TË
USHQYER ME BIOMASË TË LËNGSHME, SHËNGJIN, LEZHË) SI BURIM I
RINOVUESHËM ENERGJIE**

Në mbështetje të nenit 9 dhe nenit 39, pika 2 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 9, pikat 1 dhe 2 germa “a”, të vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.9, datë 21.2.2007 “Rregullores së procedurave të certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme”, vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.44, datë 24.7.2007 “Për miratimin e rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, neni 15, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike “ERE”, në mbledhjen e tij të datës 22.2.2008, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “Albania Green Energy” sh.p.k., për kualifikimin e impiantit prodhues (blok motorë-gjeneratorë të ushqyer me biomasë të lëngshme, Shëngjin, Lezhë) si burim i rinovueshëm energjie,

VENDOSI:

1. Kualifikimin e impianteve prodhuese (blok motorë-gjeneratorë të ushqyer me biomasë të lëngshme, Shëngjin, Lezhë) të shoqërisë “Albania Green Energy” sh.p.k., si burim i rinovueshëm energjie.
2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut dhe Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojnë aplikuesin lidhur me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta